Rruga e Arbërit

Botim Periodik i Shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë". Viti I i Botimit. **Nr. 4.** **Gusht 2006** Çmimi: **30** lekë

Shqip është shkruar në gegëni, zoti Gill

Nga **SHAQIR SKARRA**

Para pak kohësh një studies anglez shpreu dëshirën në media se kërkonte një fjalor shqip-anglisht. E veçanta e kësaj kërkese ishte se këtë fjalor e kërkonte në gegënishte. Jo vetëm një, por disa studiues të tjerë, po anglezë, janë marrë dhe vazhdojnë përsëri të bëjnë studime rreth kanunit të Lekë Dukagjinit. I thamë këto, si fillim, duke marrë shkas nga shkrimi që një gazetar anglez, i quajtur Adrian Anthony Gill, botoi një shkrim për Shqipërinë dhe shqiptarët në gazetën "Sunday Times" më datë 23 korrik 2006. Siç duket nga shkrimi, edhe mendimet që shfaq gazetari, nuk e njeh mirë realitetin shqiptar ose është i keqinformuar, por sikur thotë dhe shtypi ynë ditë më vonë, ky rast nuk është i pari i këtij gazetari. Ajo që na shqetson me të drejtë, është se autori Gill e paraqet krejt ndryshe realitetin, sidomos në veri të Shqipërisë. Fakt është se Veriu i Shqipërisë quhet gegë ose gegëni dhe jugu toskë ose toskëri. Shumë studiues dhe historianë të huaj e kanë shkelur mirë Veriun e Shqipërisë, ku shumica prej tyre veriun e quajnë Shqipëria e vjetër. Studiuesi francez Robert d'Angely, në librin e tij "Enigma", do të shprehet: "Grekërit morën rrënjën nga gjuha gege dhe formuan gjuhën e tyre". Edvin Jacques, një tjetër studiues amerikan, në studimin e tij "Shqiptarët", shprehet: "Ky popull i lashtë pellazg shënon një datë më të hershme se zhvillimi i civilizimeve të Greqisë dhe Romës" dhe më poshtë po ky autor do të shprehet: "Një episod dramatik në Trojë përputhet plotësisht me detyrimin e besës që ende është e shenjtë në malet veriore të Shqipërisë". Prifti francez Zhan Klod Faveirial, në librin e tij "Historia e Shqipërisë", do të shprehet: "Me të drejtë mburren grekërit për letërsinë homerike, por në cilat shkolla pellazgjike mësoi Homeri?" I cituam këto thënje të studiuesve të huaj, për të bindur opinionin e huaj (ato që nuk e dinë), se gegërit në veçanti

Vijon në faqen 2

Rruga e Arbërit, rrugë kryesore e vendit që në lashtësi



Pamje e urës së vjetër mbi lumin Zeza që lidhte Tiranën me Krujën. Foto B.Lleshi. Korrik 2004.

Nga Prof.Dr. BASHKIM LLESHI

SPECIALE NE FAQET 4-5

TE NJOHIM BIZNESMENET E DIBRES

Njeriu që flet pak dhe punon shumë

"Dibra ka nevojë për investime kudo, - thotë Shabani. Edhe folklori aq i pasur, studimi, historia, artet dhe kultura, investime janë. Ndaj qysh këtu duhet ndërhyrë. Të tjerë nuk kanë vlera dhe mundohen të ngrejnë ato. Ne i kemi dhe të mos i humbasim, por t'ua përcjellim brezave".


FAQE 3



Shaban Bitri

INTERVISTË

Xhamitë po i ndërton populli



Intervistë me Myftiun e Dibrës, kryetarin e Bashkësisë Islame të Shqipërisë dhe kryetarin e Komisionit të Pajtimit të Gjaqeve në Dibër, zotin Ahmet Çaushi

FAQE 7

HISTORI

Mbas shpalljes së qeverisë së përkohshme të Shqipërisë së mesme prej Esat Pashës



Vazhdon botimi i shënimeve të **Ismail Strazimirit**

FAQE 6

Shaban Xhajku - interpretuesi më i mirë i Valles, Lushnje, 2006

FAQE 8

Peshkopi, vetdeklarohen 5 000 ndërtime pa leje

FAQE 2

Bulqizë, përmbytjet mbeten shqetësim për banorët

FAQE 2

Adresa e redaksisë: Blloku i banesave "Gintash", Laprakë. Tel.068 31 19 232. E-mail: Lid_gazeta@yahoo.com.

Shqip është shkruar në gegëni, zoti Gill

Vijon nga faqja 1

dhe shqiptarët në përgjithsi nuk janë ato që njeh gazetari Gill. E dinë të gjithë shqiptarët se shqip për herë të parë është shkruar në veri dhe ky shkrim është "Meshari" i Gjon Buzukut. Ky dokument nuk ndodhet vetëm në bibliotekën kombëtare, por dhe jashtë vendit tonë. Jo vetëm kaq, por sipas studimeve të fundit në arkivat e Vatikanit, shqip është shkruar më herët, qysh në vitin 1210 nga Teodor Shkodrani. Këto janë fakte, edhe pse nuk ka dëshirë t'i pranojë gazetari Gill. Ka mundësi që ky gazetar, të jetë keqinformuar kur shan në mënyrë më brutale gegët. Në kohën kur në Firence kishte një Universitet dhe Anglia kishte kohë që njihej si shtet (në Skoci, vendlindja e gazetarit Gill, luheshin tragjeditë me mbretër) në Shqipëri (Arbëri) Skënderbeu luftonte me shpatë kundër perandorisë osmane dhe po të mos ishin Arbërit dhe Skënderbeu, ushtria e Sulltan Mehmetit do të dilte në perëndim. Skënderbeu, që vetë Papa e ka cilësuar si atlet të Krishtit, ishte gegë. Gegë ishte dhe ai që bëri kanunin e famshëm, që për atë periudhë kohe ishte një kod penal i mirëfilltë, ishte një kushtetutë për gegët. Gegë ishte dhe Vaso Pasha që u bë guvernator i Libanit. Gegë dhe Iljaz pashë Dibra që drejtoj Lidhjen e Prizrenit, Gegë dhe Nikollë Kaçorri, Vehbi Dibra. Gegë ishte dhe Isa Boletini, i cili bashkë me plakun e Vlorës Ismail Qemalin, kur kërkonte nëpër kancelaritë e Europës për pavarsinë e Shqipërisë, Bismarku do të tallej për "kasollet shqiptare". Do të tallej njëlloj si gazetari Gill një shekull më vonë. Gegë ishte dhe e famshmja Nënë Tereza, që Vatikani e shenjtëroi dhe për shqiptarët do të mbetet për jetë ikona e vërtetë. Gegë dhe At Gjergj Fishta, që vetëm me "Lahutën e Malcisë" i thuri një përmendore kombit të vet.

Mjaft gazetarë dhe analistë janë prononcuar në media të ndryshme për këto fyerje publike që na bëri një gazetar dhe gazetë angleze. Nuk pamë asnjë politikan dhe qeveritar që të prononcohen. Ndoshta shkrimi i gazetarit Gill bën fjalë vetëm për shqiptarët. Qeveritarët janë elitë dhe me elitën gazetari në fjalë nuk ka punë. Ashtu qoftë, por politikanët janë pasqyra e kombit.



Peshkopi, vetdeklarohen 5 000 ndërtime pa leje

Drejtoria i zyrës së ALUIZONI-t, në Prefekturën e Qarkut të Dibrës, Bedri Gazidede tha per gazetën "Rruga e Arbërit"se që nga fillimi i procesit të legalizimit janë tërhequr nga banorët e zonave informale rreth 7 mijë formulare. "Administrata e agjensisë ka monitoruar procesin duke ndjekur dhe zgjidhur problemet e mundshme të shfaqura, ka bashkrenduar veprimtarinë me strukturat e pushtetit vendor për të plotësuar detyrimet ligjore në funksion të procesit të legalizimit" - tha Gazidede. Sipas tij, pas tërheqjes së formularëve ka filluar edhe vetdeklarimi pranë njesive të qeverisjes lokale. Brenda 10 ditëve të para të Gushtit, janë vetdeklaruar rreth 5 mijë ndërtime dhe shtesa pallatesh pa leje. Numri më i madh i këtyre ndërtimeve ndodhen në qytetin e Peshkopisë - thote ai.

Gazidede shton se duke parë ecurinë normale të fazës së parë të këtij procesi, atë të vetdeklarimit, është menduar që paralelisht të kalohet edhe në fazën e dytë, e cila është edhe etapa me e rëndësishme e procesit, ajo e identifikimit në terren dhe në hartografi e këtyre ndërtimeve të paligjshme.

M.Lala



Bulqizë, përmbytjet mbeten shqetësim për banorët

Kanali kullues i fushës së Vajkalit që thithte ujrat e qytetit të Bulqizës, edhe këtë vit po mbetet një problem shqetsimi për banorët e këtij qyteti. Aktualisht, pellgjet e ujrave në të dyja anët e unazës janë krijuar si rezultat i mos funksionimit prej vitesh të kanalit kullues. Pikërisht, janë këto pellgje, apo më mirë liqene, që janë kthyer në vende ku grumbullohen dhe mbeturinat e shumta. Ndryshe ndodh në stinën e dimrit dhe pranverës ku reshjet e shumta të shiut sjellin dhe përmbytjen e vetë unazës. Megjithëse para tre vitesh u investua shuma 12.5 milionë lekë të reja për rehabilitimin e kanalit, gjithçka mbeti nën justifikimin e një pune jo cilsore dhe të pamotivuar mbi bazën e një projekti konkret. Ky fenomen nuk është i panjohur në Bulqizë, por i pranishëm që prej dhjetë vjetësh, duke sjellë pasoja mjaft të mëdha si dëmtimin e ish shkollës së mesme të përgjithshme, çarjen e disa pallateve përballë, nxjerrjen jashtë funksionit të mjaft lokaleve si dhe dëmtimin e rrugës kryesore që lidh dy lagjet e qytetit. Megjithëse vetë banorët e Bulqizës e kanë ngritur zërin disa herë për këto probleme, jo vetëm në pushtetin lokal, por dhe më lart, deri tani asgjë nuk po bëhet për Bulqizën, këtë qytet lindor që po humb dalngadalë dhe identitetin e dikurshëm. Ndërhyrja duhet e menjëhershme, që të mos krijohen pasoja më të rënda për banorët e Bulqizës.

Sali Imeri

SHKURT

BULQIZË, SPITALIT I MUNGON APARATI I RADIOSKOPISË

Prej tre vitesh banorët e Bulqizës po përballen me mungesën e shërbimit mjeksor radiologjik.Mosfuksionimi i aparaturës ka ardhur si pasojë e amortizimit të plotë pasi montimi i saj në spitalin e Bulqizës është bërë në vitin 1967 dhe tashmë i ka humbur të gjitha vetitë për ekzaminimin e sëmundjeve.Dhe sipas mjekëve është dhe i dëmshëm për shëndetin e pacientëve pasi tashmë ka rrezatim tepër normativës.Nisur nga ky fakt Drejtoria e shëndetit publi ka kërkuar vazhdimisht një aparaturë tjetër në Ministrinë e Shëndetsisë për tju ardhur në ndihmë këtyre banorëve të kësaj zone verilindore.Edhe pse në fund të vitit 2005 spitalit të Bulqizës i erdhi një aparaturë e përdorur më parë në spitalet e kryeqytetit nuk e pati fatin e mirë që tju shërbente pacientëve pasi brenda muajt krijoj një difekt të pariparueshëm.Aktualisht sot në spitalin e Bulqizës nuk kryhen ekzaminime të radiologjisë.Edhe ato urgjenca që ndodhin në minierë apo aksidente rrugore dhe brenda gjashtëmujorit ka patur mbi 50 të tilla janë nisur po urgjent për në Peshkopi,Burrel dhe Tiranë.Jo vetëm kaq por 70% e vizitave ditore që kryejnë mjekët e qendrës shëndetsore dhe ato të familjes duhet ti nënshtrohen ekzaminimeve si skopi dhe grafi.Vetë Ministri i Shëndetsisë është në dijeni për mungesën e aparaturën e munguar në Bulqizë dhe ka premtuar para dy muajsh se do ta sjell shpejt një aparaturë të re.Fjalët i mori era dhe ende spitali i Bulqizës vuan për ekzaminimin e sëmundjeve.Janë pacientët ato që vazhdojnë të përballen me mungesën e këtij shërbimi të domosdoshëm mjeksor, pasi shpenzimet kapin shuma të mëdha për të udhëtuar qoftë dhe për një skopi drejt Burrelit, Peshkopisë, pse jo dhe drejt Tiranës. (***S.I.)***

JO ABUZIME ME ILAÇET E RIMBURSUESHME

Drejtoresha e Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor Elvana Hana, u kerkon pensionisteve të denoncojnë rastet kur mjekët e ambulancave refuzojne t'u japin ilaçe me rimbursim, edhe kur ata janë jashtë listës së rimbursimit, si dhe të mos bien pre e orientimit të gabuar të disa mjekëve, të cilët janë të prirur t'u japin pacientëve një llojë medikamenti vetëm sepse sponsorizohen nga farmacistët. Këto komente drejtoresha Hanaj i bëri gjatë analizës 6-mujore të ISKSHsë, Dibër. Veteranët dhe invalidët përfitojnë rimbursim 100 për qind të ilaçeve dhe është detyrë e mjekëve t'i identifikojnë personat e kësaj shtrese - u shpreh Hana. ***(M.L.)***

KONTROLL PËR USHQIMET E SKADUARA

Inspektoriati i Ushqimit në Drejtorinë e Bujqësisë, Dibër, në bashkëpunim me Zyrën e kontrollit të cilësisë pranë Bashkisë Peshkopi dhe specialistë të Drejtorisë së Higjenës dhe Epidemiologjisë, ka ndërmarrë një aksion për kontrollin e ushqimeve në treg.

Nga të gjitha subjektet tregtare do të merren kampione të ushqimeve për t'u bërë analizat dhe për të parë nëse këta produkte janë brenda standarteve.

Specialistët shprehen se qëllimi i punës është kontrolli i produkteve ushqimore që i jepen konsumatorit. Analizat e kampioneve të marra tani bëhen në Peshkopi, falë ngritjes së një laboratori modern.

"Nëse subbjektet që do të kontrollohen nuk plotësojnë kushtet higjeno-sanitare, ndaj tyre do të merren masa ndëshkimore", thanë burimet e mësipërme.

Duhet theksuar fakti, që nuk kanë qënë të pakta rastet kur qytetarët janë ankuar në lidhje afatin e skandencës së mallrave ushqimorë.

KESH PESHKOPI, NIVELI I ARKËTIMEVE 76%

Niveli i arkëtimeve të energjisë elektrike gjatë 6-mujorit të parë të vitit arrin në 76 për qind. Dega e shitjes së energjisë njofton se gjatë muajt Prill ka shënuar nivelin më të lartë të arkëetimeve, por që ka pësuar sërish rënje gjatë dy muajve të fundit. Niveli i humbjeve të energjisë elektrike ka pësuar rritje duke shkuar në 41 për qind. Kjo nuk është rrjedhoje e rrjetit të amortizuar, por kjo sasi energjie vidhet nga konsumatorët.

KËSHILLI BOTUES I GAZETËS

Drejtor: **RAKIP SULI**
Kryeredaktor: **SHAQIR SKARRA**
Redaksia: **Hajri Mandri, Prof. Dr. Bashkim Lleshi, Bujar Karoshi, Dukagjin Hata, Hasan Leka, Mirvet Lala**
ADRESA E GAZETËS: Blloku i banesave "Gintash", Laprakë.
Tel.068 31 19 232. Tel: (04) 357 179.
Email: lid_gazeta@yahoo.com

Shoqata "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" ka dhe numrin e saj të llogarisë në **PROCREDIT BANK**
Në lek 13-661344-0001 . Euro 13-661344-0102 . USD 13-661344-0203

NJOFTIM

Gazeta "Rruga e Arbërit", njofton gjithë lexuesit dhe bashkëpunëtorët, se numri i radhës së gazetës do të dalë çdo të diel të fundit të muajit. Për abonimet dhe shpërndarjen e gazetës në adresa tuaj, duhet të telefononi në numrin e telefonit: **(04) 357 179,** ose të na shkruani në **Email: lid_gazeta@yahoo.com**

Reklamoni biznesin tuaj!

Gazeta "Rruga e Arbërit" vë në dispozicion hapsirat e nevojshme për reklamën tuaj!
Tel.**068 31 19 232.**
Tel: **(04) 357 179.**
Email: **lid_gazeta@yahoo.com**

TË NJOHIM BIZNESMENËT E DIBRËS

Njeriu që flet pak dhe punon shumë

Nga SHAQIR SKARRA

Edhe një sy i pavëmendshëm, ka vënë re gjatë rrugës automobilistike Vorë-Tiranë, mjaft mbikalime metalike të ngritur bukur dhe me shije profesionale. Janë pikërisht këto mbikalime që kanë bërë të mundur të ulet mjaft numri i aksidenteve në këtë rrugë nga trafiku mjaft i madh i makinave. I kemi parë të gjithë këto mbikalime, kemi parë dhe njerzit që kalojnë mbi to, por shumë veta nuk dinë gjë për firmën ndërtuese. "Almo Konstruksion" është zbatuese e tyre e ka festuar tashmë dhjetë vjetorin e saj. Dhjetë vjet nuk i thonë pak në aktivitet privat, por kjo firmë falë Presidentit të saj, inxhinierit të ndërtimit, njeriut që ka derdhë djersë dhe dije në veprat e mëdha të dritës, Shaban Bitri, ka me se krenohet në këtë përvjetor.

"E filluam në gusht të vitit 1993 aktivitetin privat bashkë me një shkodranë në ortakëri", - thotë Shabani. "Firma e përbashkët quhej "Jubica". E filluam mirë. Punuam kudo në të gjithë vendin, por më së fundi vendosëm të ndahemi, fundja dhe vëllezërit vjen një kohë e ndahen". Në vitin 1996 Shaban Bitri themelon shoqërinë e ndërtimit "Almo Konstruksion" me vendim të gjykatës, Nr.1114381, datë 28.03.1996, me qendër në qytetin e Shkodrës. Aktualisht me seli në Tiranë, sipas vendimit Nr. 6821, datë 13. 07. 1999, dhe filial në Shkodër. Inxhinieri i veprave të mëdha, Shaban Bitri, ndjehet krenar për atë që ka arritur shoqëria "Almo Konstruksion" në këto dhjetë vite. Sot, në historikun e "Almo Konstruksion" shënohen një sërë veprash të rëndësishme të ndërtuara dhe ristrukturuara

"Në fillim e nisëm me objekte të vogla, - tregon Shabani, - si ristrukturime shkollash dhe qendra shëndetsore, rrugë e ura. Më vonë me plotësimin e firmës me makineritë e duhura dhe personelin inxhiniero-teknik, filluam dhe të ndërtojmë objekte të rëndësishme". Mjafton t'i hedhim një sy curiculum-it të shoqërisë së ndërtimit "Almo Konstruksion" dhe bindesh në seriozitetin dhe profesionalizmin që kanë.

Ia vlen të ndalemi në atë që shënohet në historikun e saj:

Janë ndërtuar: Ura e Fishtës në Lezhë, Ura e Melanin dhe e Blliçes në Dibër, Ura e Radhimës në Vlorë, Ura Gomsiqes në Shkodër, Ura e Bletasit në Tiranë. Urat, sidomos ato të lartësive të mëdha, kërkojnë një specifikë të veçantë në ndërtim, por janë të gjitha këto ura të ndërtuara nga "Almo Konstruksion", falë një personeli inxhiniero-teknik të specializuar dhe makinerive moderne që nuk i mungojnë tashmë kësaj shoqërie. Fundja, vetë Shaban Bitri, është një inxhinier i talentuar ndërtimi, i cili ka


JETA

Shaban Bitri lindi në në janar të vitit 1949 në fshatin Blliçe, në një familje atdhetare dhe patriotike. Shkollën fillore e mbaroi në fshatin e lindjes, ku ende e mban mend mësuesin e parë, Selman Totën. Shkollën shtatëvjeçare e mbaron me nota të mira në Fushë Alie, në vitin 1964. Vazhdon studimet në teknikumin e mesëm të ndërtimit në Tiranë, të cilin e përfundon në vitin 1968 dhe, po në këtë vit, fillon punë në Pukë, si teknik i mesëm deri në vitin 1970. Shkëputet nga Puka për të vajtur në metropolin shqiptar, ku do të vazhdontë studimet e larta në fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, të cilin e përfundon shkëlqyeshëm në vitin 1974. Në këtë periudhë, kishte filluar të lartohej diga e hidrocentralit të Fierzës. Shaban Bitri fillon punë në fillim pranë këtij hidrocentrali, si inxhinier ndërtimi, dhe shumë shpejt bëhet kryeinxhinier kantieri. Në vitin 1986, kryeinxhinier kantieri në hekurudhën Milot-Rrëshen. Në vitin 1988 kryeinxhinier dhe kryetar i degës teknike në ndërmarrjen e ndërtimit të rrugëve Shkodër deri në vitin 1993, vit ky ku shkëputet dhe fillon aktivitet privat me ortakëri me firmën "Jubica".

Shabani është i martuar dhe ka dy djem. Edmondi, djali i madh, ashtu si babai, ka mbaruar fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, është i martuar dhe ka dy fëmijë. Pra, Shabani tashmë është bërë gjysh. Alfonsi, djali tjetër, ka mbaruar për gjuhën gjermane dhe shkenca politike në Vjenë. Të dy djemtë punojnë bashkë me Shabanin dhe janë pikërisht këto që duke bashkuar germat e emrave të tyre, formuan në vitin 1996 shoqërinë e ndërtimit "Almo Konstruksion". Jo vetëm djemt e tij, por është fakt, se edhe vëllezërit e Shabanit, janë të gjithë të arsimuar. Ishte rast i parë që në Blliçe vinte nuse një vajzë nga jugu, dhe Afrovita u bë shumë shpejt njeriu më i dashur dhe respektuar për të gjithë banorët e këtij fshati verior. Edhe pse Shabani pas martesës shkoi në Koman, ajo në Blliçe qëndroi vetëm disa vite me radhë, duke punuar si arsimtare në shkollën e fshatit. Një familje e madhe, por arsimdashëse. Bilbil Bitri, një emër i njohur në media, një ushtarak me përvojë, drejtoi forcat paqëruajtëse shqiptare në Irak. Sot, ndodhet në SHBA si përfaqësues i shtetit shqiptar pranë Shtabit të Përgjithshëm në luftë kundër terrorizmit. Po kështu dhe Lutfiu e Rruzhdiu. Një rast ky ndoshta i vetëm, që në një familje të gjithë të arsimuar.



Edmondi dhe Alfonsi



Shaban Bitri

lënë gjurmë në veprat e mëdha të dritës që janë ndërtuar vite më parë. Jo vetëm kaq, por kjo shoqëri tashmë ka një aktivitet të ngjeshur kudo ku ndërtohet në vendin tonë, sidomos në rrugë, ura por edhe në objekte të tjera. Ka ndërtuar dhe ristrukturuar objekte të ndryshme si: reparti ushtarak Nr. 1100 në Shkodër, ndërtime ndërtesa dy katëshe në Kamëz, rikonstruksion rrugë e sheshe në qendrën spitalore në Tiranë, rikonstruksioni i shkollës "Perlat Rexhepi"në Shkodër, ujësjellsi Gjokaj në Vorë, mbrojtja e rrymëshpejtuesit në Bovillë, ndërtim rruge në Baldushk, riveshje pjese në rrugën Maminas - Durrës, rrugë lidhëse në Kashar, ndërtim rruge në Sauk, sistemim dhe asfaltim rruge në Shkozë, rikonstruksionin e shkollës "Xhezmi Delli" dhe "Ismail Qemali", kolektori kryesor në Laprakë, punime urgjente në fushën e Sharrës, ndërtimi i pallatit sportit në Shijak, sistemim asfaltim rruga Burrel-Bulqizë (Klos), sistemim dhe asfaltim Laç-Kisha e Shën Ndout, rikonstruktim dhe ndërtim shtese shkolla "Ali Demi" në Tiranë, e shumë e shumë të tjera. Vetëm po të numrohen mbikalimet metalike nga Vora në Tiranë, bindesh se shoqëria e ndërtimit "Almo Konstruksion"është afirmuar bukur tashmë dhe nga ana profesionale. Por, për shoqërinë "Almo Konstruksion" dhe Shaban Bitrin, njeriun që flet pak dhe punon shumë, këto janë pak, fare pak. Themi me bindje se ajo që ia rrit më shumë vlerat kësaj shoqërie është Ura e Zogut. Shumë veta e njohin si Ura e Milotit. Fakt është se e vetmja urë e këtij lloji ndodhet në Shqipëri. Kjo urë e veçantë do të humbiste shumë shpejt, jo vetëm identitetin e saj, por ndoshta në një të ardhme do ta mbulonte të tërën lumi i Matit. Ristrukturimi i saj ishte tepër i vështirë, pasi duhej ndërhyrë, por me kujdes, pa cënuar konstruksionin e parë. Shaban Bitri, si njeri me kurajo dhe inisiativë, por dhe duke besuar në aftësitë e stafit të shoqërisë "Almo Konstruksion", e mori përsipër ristrukturimin e këtij objekti të rëndësisë së veçantë. Sot, Ura e Zogut në Milot, ka një tjetër pamje, bindesh se këtu kanë punuar njerëz profesionist dhe me shije në ndërtim.

I LIDHUR NGUSHTË ME VENDLINDJEN

Shoqëria e ndërtimit "Almo Konstruksion" sot ka afro 50 punonjës të profesioneve të ndryshme. Janë të gjithë të siguruar dhe të përhershëm, ndërsa kur lind nevoja për punëtorë sezonal, ato merren nga rrethet ku po kryhet investimi. Përqindjen më të madhe të punonjësve e ka Dibra, kjo për të vetmen arsye se dhe Shabani është i lidhur ngushtë me vendlindjen. Kësaj shoqërie nuk i ka rastisur shumë të investojë në Dibër, por nuk mund të themi se Shaban Bitri ka braktisur Dibrën. Rruga Kuben-Kala e Dodës po mirëmbahet nga shoqëria "Almo Konstruksion". Nëqoftëse deri para disa vitesh ishte katandisur në një gjendje që vështirë e kishin edhe mjete me zingjir, sot kjo rrugë është e kalueshme në çdo stinë të vitit, bile dhe në dimrat e egër kur bora mbulon gjithçka. Sot nëpër këtë rrugë kalojnë dhe mjetet e Kuksit lirshëm, duke e braktisur "Rrugën e Dritës".

"Kjo është pak, - thotë Shabani. - Ne duhet të investojmë më shumë për Dibrën, por kryesore mbetet infrastruktura. Ajo ka nevojë për ndërhyrje.

(Vijon në faqen 7)

VEPRA TË NDËRTUARA DHE RISTRUKTURUARA



Rruga e Arbërit, rrugë kryesore e vendit

Prof.Dr. Bashkim LLESHI



Pamje e urës së vjetër mbi lumin Zeza që lidhte Tiranën me Krujën. Foto B.Lleshi. Korrik 2004.

Për rëndësinë e madhe të kësaj rruge flet edhe Marrëveshja tregetare e Republikës së Raguzës dhe Gjon Kastriotit e vitit 1420, e cila siguronte tregëtarët Raguzanë të bënin tregëti dhe të kalonin lirisht në trojet e Kastriotëve si dhe për të kaluar në drejtim të Kosovës.

Rruga e Arbërit, krahas rrugës Egnatia, si dega më e rëndësishme e saj,duke qenë edhe si një nga rrugët më të rrahura që në lashtësi, në periudhën qytetare Ilire, në periudhen e vonë Antike dhe Mesjetare, Rilindjes Kombëtare e deri në vitet pesëdhjetë të shekullit që kaloi, do të shërbejë edhe për njohjen e historisë së lashtë të popullit tonë.

Historiani dhe Arkeologu i shquar dibran Iljaz Kaca, në librin e tij "Rrugët e vjetra të Dibrës", mbështetur në burime të shumta historike dhe arkeologjike të studjuesve të huaj dhe shqipëtarë, jep të dhëna të hollësishme të itinerarit dhe funksionimit të kësaj rruge qysh në periudhën paraurbane, prehistorike, nëpërmjet gjetjeve arkeologjike të kësaj periudhe dhe kontaktet kulturore në prehistori midis banorëve të treves dibrane dhe atyre të bregdetit, ku përshkruhet lugina e Bulqizës si shtegu më i përshtatshem i trevës dibrane për t'u lidhur me luginën e sipërme të Matit.

Nëpër këtë shteg kalonte rruga e vjetër Dibër-Mat-Bregdet. Pra, kjo rrugë është përdorur qysh në prehistori për të lidhur qendrat prehistorike të Kronezes, Gradecit, Cetushit, Pesjakes, Burimit, Topojanit, duke kaluar Drinin tek ura e Topojanit me va, për të vazhduar më tej në drejtim të qytezave të Sofracanit e Krajkes, tek ura e Qytetit, në qytetin e Valikardhës, Vajkal, Qaf Buall, gryka e Planit të Bardhë, qyteza e Xibrit në Mat, Krujë e Durrës ose përmes luginës së mesme të Matit në Lezhë e Shkodër.

Në periudhën qytetare ilire itinerari i kësaj rruge kushtëzohej nga qendrat e rendësishme qytetare ilire si Grazhdani (Uskana), Zgerdheshi (Albanopolisi) dhe Dyrrahu.

Rruga mbrohej nga disa pika kyçe, ku u ndërtuan disa qyteza e kala si qytezat e Sofracanit dhe të Krajkës, qyteti i Valikardhës, qyteza e Xibrit në Mat. Këto vendbanime të fortifikuara të trevës Dibrane ishin ngritur në funksion të qytetit antik të Grazhdanit (Uskana), kryeqendrës së trevës dibrane qysh në antikitet, kryeqendrës ekonomike, politike dhe ushtarake, e njohur me emrin Uskana antike me 10 000 banorë.

Rruga Dibër-Tiranë-Durrës lidhej me rrugën transversale Durrës-Lezhë-Shkodër nëpërmjet Krujës, duke u takuar në Burizanë ku ishte stacioni ku kryqëzoheshin dy rrugë shumë të rëndësishme që lidhnin krahinat veriore e veri lindore të Shqipërisë. Nëpërmjet kësaj rruge lidheshin dy kalatë ilirë të Xibrit në Mat dhe Zgërdheshit në Krujë, nga shtegu më i përshtatshëm i Grykës së Shkallës së Zezë në veri të fshatrave Mukje e Kurcaj të rrethit të Krujës.

Në këtë periudhë edhe rruga Dibër e Madhe-Tiranë-Durrës ishte e po të njëjtës rëndësi sa rruga Grazhdan-Tiranë-Durrës.

Nga Dibra e Madhe kalohej tek urat e Gjoricës-ura e Cerenecit, ose Dibër e Madhe-Ura e Spiles-Ura e Mireshit-Ura e Cerenecit ku bëhej takimi me

Rruga e Arbërit është përdorur qysh në prehistori për të lidhur qendrat prehistorike të Kronezes, Gradecit, Cetushit, Pesjakes, Burimit,Topojanit, duke kaluar Drinin tek ura e Topojanit me va, për të vazhduar më tej në drejtim të qytezave të Sofracanit e Krajkes, tek ura e Qytetit, në qytetin e Valikardhës,Vajkal, Qaf Buall, gryka e Planit të Bardhë, qyteza e Xibrit në Mat, Krujë e Durrës ose përmes luginës së mesme të Matit në Lezhë e Shkodër.

rrugën që vinte nga Grazhdani e Dibra e Poshtëme për të vazhduar për në Tiranë e Durrës, ose Dibër e Madhe-Reshan-Ura e Topojanit, ku takohej me rrugën që vinte nga Grazhdani për të vazhduar në drejtim të Tiranës.

Në periudhën e vonë Antike dhe Mesjetare, itinerari i kësaj rruge vazhdon të jetë po ai i përshkruar në periudhat më të hershme, duke pësuar përmirësime në drejtim të shtimit të sistemeve fortifikuese brenda dhe jashtë trevës dibrane, si në kalanë e Grazhdanit, Gradishta e Vojnikes (vp i Topojanit), Meja e Kalasë e Homeshit (kala e periudhës osmane), qyteza e Sofracanit dhe e Krajkës (kala të vona antike e mesjetare) dhe qyteti i Valikardhës me kullën e Skënderbeut, e cila përmendet për qëndresën heroike të Heroit tonë Kombëtar, Skënderbeut kundra pushtuesve osmane, ku gojëdhënat e popullit ruhen deri në ditët e sotme për zgjuarësinë e tij për të kaluar situata të vështira.

Skëndërbeu i rrethuar nga ushtria osmane në kullën e tij, urdhëron të ushqehet një mushkë me grurë dhe të hidhet nga shkëmbi i kullës. Kur mushka ra poshtë në lum, turqit muarën vesh se Skëndërbeu paska aq shumë grurë sa për të ushqyer dhe mushkat dhe e ngritën rrethimin duke menduar se nuk mund të merret me anë të urisë.

Jashtë trevës Dibrane ndodhet kalaja e Petralbës në Gur të Bardhë e përmendur si fortesë e ndërtuar nga Skënderbeu në mbrojtje të kësaj rruge për të penguar lëvizjen e ushtrisë osmane në drejtim të Krujës e bregdetit.

Edhe gjatë Mesjetës, pas Urës së Qytetit në Valikardhë, si stacion kryesor i rrugës Dibër-Tiranë ka qënë Guri i Bardhë. Dëshmi e këtij stacioni janë urat me hark si Ura e Vashës dhe Ura e Skurës që ruhen deri në ditët e sotme, kalldrëmet, 2 karakollet, 8 hanet dhe kështjella e Petralbës, gjurmët e të cilave ruhen gjithashtu deri në ditët e sotme.

Edhe në Qafë Murrizë, në Qafën e Lajthizës, në Zall Dajt, në grykën e Tujanit ruhen gjurmë kalldrëmi të Mesjetës së hershme. Gjurmë të tilla janë edhe Ura e Brarit, urë guri me një hark, e ndërtuar mbi lumin e Tiranës, gjurmët e një kulle dhe një kishe në fshatin Brar, fshati Vendsha (Shupali i sotëm), etj.

Për rëndësinë e madhe të kësaj rruge flet edhe Marrëveshja tregetare e Republikës së Raguzës dhe Gjon Kastriotit e vitit 1420, e cila siguronte tregëtarët Raguzanë të bënin tregëti dhe të kalonin lirisht në trojet e Kastriotëve si dhe për të kaluar në drejtim të Kosovës.

Pas pushtimit osman, qyteti i Grazhdanit braktiset përfundimisht dhe kryeqendra e Dibrës kalon në qytetin e Dibrës së Madhe (Shehri i Dibrës).

Në këtë periudhë edhe Tirana hedh themelet e një qyteti të ri dhe nga një fshat në shekullin e XIV-XV, kur feudali Sulejman Pasha në vitin 1614 ndërtoi shtëpinë e vet, një xhami, më vonë trashëgimtari i tij Ibrahim Beu ndërtoi një kala dhe një ujësjellës, kështu që në fillim të shekullit të XVIII Tirana fillon të marrë tiparet urbane të një qyteti duke arritur me 500 shtëpi dhe një pazar me 150-200 dyqane.

Me rrugën Dibër-Tiranë-Durrës janë të lidhura dhe tregëtia që zhvillohej në panairet e Durrësit, Tiranës, Dibrës, Tetovës, etj. Lidhjen e Dibrës me bregdetin e kushtëzonte edhe mungesa e disa artikujve si kripa, vajguri, etj., që vinin nëpërmjet detit. Kjo dëshmon për aktivitetin e madh që kryhej nëpërmjet kësaj rruge qysh në mesjetën e lulëzuar.

Rruga Dibër-Tiranë-Krujë-Durrës është përdorur edhe si rrugë strategjike nga ushtritë e huaja. Interesimi i pushtuesve osmanë për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e kësaj rruge nëpërmjet fshatrave dervene si Bulqiza, Klosi, Guri i Bardhë e Tujani, tregon për rëndësinë që zinte kjo rrugë në sistemin rrugor të kohës, për qëllime ushtarake dhe ekonomike. Pra, kjo ishte ndër rrugët e mëdha e kryesore të vendit, krahas rrugës Egnatia, rrugëve të bregdetit dhe rrugës Durrës-Lezhë-Shkodër-Prizren. Kjo rrugë lidhte Dibrën në perëndim me bregdetin dhe ne ëindje me Gostivarin, Tetovën, Shkupin dhe akoma më në lindje deri në Stamboll.

Si rrugë me karakter strategjik për lëvizjet e ushtrive osmane në drejtimin Dibër-Krujë dhe anasjelltas, përmenden edhe rrugë të tjera si rruga, Dibër-Zerqan-Kaptine-Shengjergj-Krujë, e cila mund të përdorej vetëm për 6-7 muaj në kohët pa reshje. Kështu, pra, si rrugë kryesore mbetej ajo Dibër-Bulqizë-Guri i Bardhë-Tujan-Krujë. Kjo vërtetohet me fragmentet e kalldrëmeve të periudhës së vonë antike në Gur të Bardhë, të mesjetës së hershme në Grykën e Tujanit, të antikitetit të vonë e mesjetës së hershme, në Grykën e Shkallës së Zezë, sistemi fortifikues në roje të kësaj rruge, si qytezat, karakollet, kështjellat, ndërtimet inxhinjerike, si urat, etj.

Krahas studjuesve dhe kalimtarëve të huaj, për periudhen mesjetare të rrugës Dibër-Tiranë kanë shkruar edhe shumë studjues Shqipëtarë, si V.Kormaku, J.Adami, V.Shtylla etj., të cilët përshkruajnë itinerarin e kësaj rruge nëpërmjet burimeve të shkruara, gjetjeve arkeologjike, sistemit fortifikues, fshatrave dervene (fshatra që siguronin rrugën dhe mblidhnin taksat e rrugës), urave, kalldrëmeve, haneve si dhe vrojtimeve të kryera në terren.

Në periudhën nga shekulli i XIX deri afër gjysmës së shekullit të XX, kur Tirana ishte fuqizuar tashmë si qytet edhe rruga Tiranë–Dibër, e cila vazhdonte sipas të njëjtit itinerar filloi të ketë lëvizje më të mëdha e më të organizuara. U shtuan përgjatë rrugës hanet dhe karakollet në mbrojtje të rrugës, u ndërtuan dhe rindërtuan urat që janë dëshmi e vazhdimit të rrugës edhe gjatë shekujve të XVIII-XIX, si ura e Brarit në afërsi të Tiranës, ura e Vashës dhe ura e Skurës në zonën e Gurit të Bardhë etj.

Në këtë periudhë filloi një veprimtari më e madhe ekonomike e tregëtare, si rrjedhim u fuqizuan qytetet, sidomos qyteti i Durrësit, i cili në gjysmën e dytë të shekullit të XIX filloi të bëhet një skelë e rëndësishme kombëtare, si për importet ashtu



Pamje e urës së vjetër të Brarit mbi lumin Tirana. Foto B.Lleshi. Maj 2001.

krahas rrugës Egnatia që në lashtësi

edhe për eksportet e vendit. Durrësi si porti kryesor i vendit lidhte Shqipërinë me krahinat e Maqedonisë Perëndimore, të Ballkanit e më në lindje deri në Stamboll.

Gjallërim të veçantë rruga Dibër-Tiranë-Durrës mori gjatë Rilindjes Kombëtare. Panairet e Dibrës, Shkupit, Tiranës e Durrësit i jepnin gjallëri gjithë rajonit nga kalonte kjo rrugë. Për gjatë kësaj rruge organizoheshin për qëllime tregëtare edhe pazare javore, siç ishin 4 pazaret e Matit, ku ndër më të rëndësishmit që vazhdon deri në ditët e sotme ishte edhe Pazari i Urës në Klos. Këto pazare frekuentoheshin nga tregetarët e Dibrës së Madhe, Krujës, Tiranës, Durrësit e deri të Elbasanit, të cilët kishin në Mat agjensitë e tyre për tregëtimin e mallrave. Në këtë periudhë filloi të shtohej numri i dyqaneve, i haneve dhe i zejtareve në fshat, duke e shtrirë rrjetin tregëtar edhe në fshat.



Pamje e urës së vjetër të Vashës mbi lumin Mati. Foto B.Lleshi Shtator 2004.

Këto dyqane u ngritën pranë haneve të vjetër, pranë urave të lumenjve, stacioneve rrugore, etj., siç ishin në rrugën Tiranë–Dibër dyqanet dhe hanet pranë Urës së Qytetit, ku zhvillohej edhe një pazar që quhej "Pazari i Qytetit".

Prania e haneve pothuajse në çdo fshat për gjatë rrugës dëshmon për gjallërimin e kësaj rruge në këtë periudhë. Kur kishte lëvizje të mëdha karvanesh, të cilat arrinin deri në rreth 300 kuaj në ditë edhe katet e para të shtëpive përdhese ktheheshin në hane.

Në librin "Rrugët e vjetra të Dibrës" të studjuesit Iljaz Kaca, mbështetur në burimet e shkruara të studjuesve V.Kormaku dhe J.Adami dhe njoftimet e studjuesit V.Shtylla, jepet rindërtimi i trasesë së rrugës Dibër-Tiranë-Durrës.


Kokë nisja e kësaj rruge fillon në qytetin e Dibrës së Madhe, si kryeqendra e treves Dibrane qysh pas pushtimeve osmane e sidomos gjatë Rilindjes Kombëtare.

Nga Dibra e Madhe rruga vazhdonte në tre drejtime për të arritur tek Ura e Cerenecit. Ura e Cerenecit ishte pika referuese për udhëtarët që vinin nga Dibra e Madhe, ndërsa Ura e Topojanit për udhëtarët që vinin nga Dibra e Poshtme.

Rruga, pasi kalonte Urën e Cerenecit, vazhdonte përafërsisht me rrugën e sotme automobilistike, në Sofracan, ku kishte një han, edhe sot ruhet toponimi "Qafa e Hanit", te Gurrat e Sofracanit, Gotvi, përballë Krajkës, Peladhi, Ura e Qytetit, e cila ishte pika referuese për udhëtarët e të dy Dibrave. Këtu ndodheshin tre hane që sot quhen "Hanet e Qytetit". Sot aty shihen vetëm rrënojat e hanit të Letit dhe në vendin e quajtur Fusha e Qytetit bëhej një Pazar që quhej "Pazari i Qytetit".

Pastaj rruga vazhdonte në drejtim të Qafës së Buallit, zbriste në luginën e fshatit Plani i Bardhe dhe dilte në lagjen Bokas në fund të fshatit, kalonte mbi shtëpitë e lagjes Bardhi, nëpër Shkëmbin e Gjatë në faqen malore të Verrithit deri tek Kodra e Kuqe e Cezma e Verrithit, tek Livadhi i Skënderit dhe zbret tek Ura e Vashës ku ndodhen rrënojat e një Karakolli.

Pas studimit të fizibilitetit, varianti me i leverdisshëm i rrugës doli sipas aksit nga ka kaluar Rruga e Arbërit, e cila, siç u përshkrua me lart, fillimet e saj i ka qysh në lashtësi, ashtu si dhe Via Egnatia.



Skema e marrë nga libri "Rrugët e vjetra të Dibrës" me autor Iljaz Kaca.

Nga Ura e Vashës, urë e gurtë me hark me dopjo qemer, mbi lumin e Matit e ndërtuar në gjysmen e dytë të shekullit të XVIII, kalohet në Urën e Skurës mbi lumin e Almetës, edhe kjo urë guri me hark e ndërtuar rreth fundit të shekullit të XVIII.

Në vazhdim rruga ngjitet në drejtim të fshatit Guri i Bardhë që ka qënë stacioni kryesor i rrugës së Dibrës me 8 hane, dy karakolle e kalaja e Petralbës, duke vazhduar nga hani afër Urës së Skurës, te varrezat e vjetra të lagjes së poshtme të Gurit të Bardhë, te kroi i Laskut, te varrezat e fisit Alla dhe ngjitet për në Qafë Murrizë, ku ndodhej një karakoll dhe një han.

Nga Qafë Murriza rruga zbret në Kutriç, ku kishte një han dhe në Zall Dajt, ku kishte një han dhe një shpellë në Qaf Lajthize, nga e cila vrojtohej e kontrollohej rruga. Nga Zall Dajti rruga ngjitej në Shkallën e Tujanit, në Tujan, zbriste në Shtish Tufinë, tek Rrapi i Treshit dhe hynte në qytetin e Tiranës në rrugën që edhe sot e kësaj dite e ka emrin "RRUGA E DIBRËS"

Nga Tirana rruga vazhdonte për në Durrës nga gryka e Vorës në drejtimin Tiranë-Kashar-Vorë-Marikaj-Shijak-Durrës, duke mos braktisur në këtë kohë edhe rrugën e Kavajës, që mbahet e gjallë dhe funksionon edhe në ditët e sotme.

Profesor Valter Shtylla, në studimin "Në gjurmët e rrugës së vjetër Durrës-Fushë e Tiranës-Dibër, pasuri e trashëguar në shekuj" në vitin 1984, shkruan se "kjo rrugë ishte një ndër rrugët më të realizuara nga ana teknike dhe me të rrahurat, deri në 300 kuaj në ditë".

Prandaj, nuk është për tu habitur nga fakti që pas studimit të fizibilitetit, varianti me i leverdisshëm i rrugës doli sipas aksit nga ka kaluar Rruga e Arbërit, e cila siç u përshkrua me lart, fillimet e saj i ka qysh në lashtësi, ashtu si dhe Via Egnatia, duke u konsideruar si pjesë apo degë e saj në të cilën janë bërë përmirësime të vazhdueshme në shekujt XII dhe më vonë në të XV-XIX, si ndërtime kalldrëmesh, urash, karakollesh, hanesh etj., e përdorur gjerësisht, sidomos në kohën e Skendërbeut dhe me vonë si rruga më e shkurtër për të lidhur Dibrën e Rajonet më në lindje, me Tiranën e Durrësin. (Shih "Historia e rrugëve të Shqipërisë" të Josif Adamit, "Rrugët dhe urat e vjetra të Shqiperise" të Profesor Valter Shtyllës, botim i vitit 1997 dhe "Rrugët e vjetra të Dibrës" të Iljaz Kaces, botim i vitit 2003).

Për këtë arsye populli i Dibrës, këtë rrugë të punuar brez pas brezi e ka ëndërruar dhe kërkuar vazhdimisht, për këtë arsye edhe qeveritë e krijuara pas vitit 1990 e kanë planifikuar për ta ndërtuar këtë rrugë. Eshtë e pafalshme që kjo rrugë si rruga më e shkurtër që ka lidhur Dibrën me Tiranën e Durrësin qysh në lashtesi nuk u ndërtua për 50 vjet të regjimit komunist dhe, është akoma më e pafalshme që brezi ynë me mundësi akoma më të mëdha që i janë krijuar me futjen në ekonominë e tregut të zvarrise fillimin e punës për hapjen e kësaj rruge që me të drejtë edhe Prefekti i sotëm i qarkut të Dibrës, zoti Xhafer Seiti, zhvillimin e mëtejshem të kësaj zone e lidh pazgjidhmerisht me ndërtimin e kësaj rruge.

Për këtë arsye edhe Shoqata 'Nisma Dibrane', e krijuar në Peshkopi nën drejtimin e studjuesit Iljaz Kaca, qysh në vitin 2000 ngriti grupin e punës që përpiloi relacionin e shkurtër teknik për hapjen e kësaj rruge.

Për sensibilizimin e opinionit qytetar dhe shtetëror për hapjen e kësaj rruge janë organizuar takime disa herë nga shoqatat "Bashkësia Dibrane" në Tiranë dhe "Votra Dibrane" në Dibër të Madhe, eshte shkruar në gazetën "Dibra" në Tiranë, janë përpiluar kërkesa e relacione, postera e kalendare, nga studjues, intelektuale e deputete, deri sa më në fund, në vitin 2003, përfundoi studimi i fizibilitetit të kësaj rruge dhe në vitin 2004 ky studim u miratua në Këshillin Kombëtar të Rrugëve.

Edhe shoqata "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" në Tiranë, e krijuar në Maj të ketij viti, organin e saj të shtypit e ka emërtuar "RRUGA E ARBERIT", duke e quajtur si një nga detyrat e saj prioritare, sensibilizimin e opinionit shtetëror për fillimin nga puna të ndërtimit të kësaj rruge, duke i bërë kështu shërbimin më të madh jo vetëm popullit të Dibrës, por edhe gjithë shqipëtarëve të Shqipërisë, Maqedonisë, Kosovës, e me tej, Turqisë deri në Stamboll.

Tiranë, Korrik 2006

OPINION

Kushtrim dhe shpresë

Nga **ILMI DERVISHI**
PETRIT DUNGA

"Rruga e Arbërit" dhe gazeta. Të dyja me të njëjtin emër, që ngjallin shpresë!

Sipas Çabejt, "Arb" do të thotë jetim. Por "jetim" këto zona i ka bërë vetëm "Rruga". Ata janë jetimë për infrastrukturën që lidh fshatra e qytete të një zone të gjerë. Të një zone të përshkuar në këmbë nga të parët tanë për të hyrë në Tiranë. Nga Kukësi e Dibra, Mati e Golloborda, me karvane e bagëti! Eh, ç'nuk hoqën! Rituali i vuajtjeve të banorëve të kësaj Shqipërie vazhdon. Po tani, ç'po bëhet. Nuk e meriton ky vend, Shqipëria jonë, që këto krahina plot histori e tradita të jenë me infrastrukturën e nevojshme?

Ku shkoi i gjithë ai masiv kromi që s'mjaftoi kurrë të bëhej një rrugë e tillë? Ku shkuan pyjet e Martaneshit, të Dejës, të Lurë? Ku shkuan pemët, perimet e drithërat e bukës të Luginës së Matit e Drinit të Zi? Ku shkoi blektoria e zonave të tëra që jo pak dhe kohë pas kohe kanë paguar për shtetin?

Kjo zonë ka pyje që janë përdorur barbarisht, por po ribëhen; ka kullota që të mahnisin me shumëllojshmërinë e luleve e barnave, ka toka e lugina pjellore, ka burime minerare e energjitike, për të cilat sot kemi nevojë më tepër se kurrë. Mbi të gjitha, ka njerëz që besojnë në ideale e shpresën te Zoti e te të zgjedhurit!.

Ata presin të ndryshojë infrastruktura, që fëmijët tyre të investojnë në vendlindje!

Po të kalosh në këmbë fshatrave ku kalon Rruga e Arbërit, do shikosh kullat e gdhendura me gur, të braktisura për një jetë më të mirë në zonat fushore e bregdetare!

Shpresojmë që shoqatat dibrane, intelektualët dibranë, të zgjedhurit dibranë e më gjerë, të bëjnë çështë e mundur të ndërtohet kjo rrugë! Pas shoqatës "Nisma Dibrane" me të nderuarit Iliaz Kaca e me të palodhurin Hysen Uka, pas shoqatë "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" me gazetën e saj "Rruga e Arbërit", pas biznesmenëve e intelektualëve të tjerë të të gjitha fushave, veçanërisht inxhinierët e ndërtimit të rrugëve, Faruk Kaba e Bashkim Lleshi, duhet të bashkohemi të gjithë për të bërë të mundur hapjen e kësaj rruge! Me ndërtimin e saj askush nuk është i humbur! Njerëzit do lëvizin më lirshëm e më shpejtë. Biznesmenët do të investojnë në këto zona. Qytetarët do kenë më shumë prodhime bujqësore e blektorale bio, fshatrat do kenë më shumë punë e të ardhura.

Arbëria do jetë më e bukur!

Botohen për herë të parë shënimet e ***Ismail Strazimirit***

Mbas shpalljes së qeverisë së përkohshme të Shqipërisë së mesme prej Esat Pashës



(Vijon nga numri i kaluar)

Esat Pasha e kishte shpallë qeverinë e përkohëshme të Shqipnisë së mesme dhe vetë ishte bamë kryetar i saj. Mbasi u lirue prej serbëve luftimi i 1913-tës nga ana e Dibrës, pune e cila u bam bas presionit t'Europës me 23 tetor 1914, unë shkova në Dibër të vogël si nënprefekt i emëruem prej Aqif Pashës, prefekt i Elbasanit. Aso kohe, pat ardhë nga Vlona në Durrës Myftiu i përgjithshëm Z.Vehbiu, për me e përshëndet komisionin që do të caktonte kufijt e Shqipnisë dhe pat qindrue aty. Esatin Myftiut të përgjithshëm, Z.Vehbiut, përveç kësaj pune i dha edhe një nder tjetër tue e bamë Senator edhe Sefedin Pustinën dhe të nipin e Ali Bej Zajmit. Faik Beun e bani sekretarin e Senatit. Të gjitha këto, Esati i bante me qëllim që ti fitonte dibranët për vete, të cilëve prej kohësh u kishte dhanë randësi të madhe. Po me këtë qëllim çoi në rrethet e Dibrës Hafiz Hysni Kerliun, Eqerem Camin e disa të tjerë, tue propogandue në favor t'Esatit, për të cilin thoshin se asht fetar, atdhetar, mbrojtës i fesë dhe i popullit. Besnikët e tij kundrejt fesë e atdheut, thojshin ata; Esati e provoi me shërbimin që i bani në Shkodër në kohë të luftës.Veç kësaj qenë dërgue njerëz ndër katunde të Dibrës të cilëve u qe propozue që të shkruejshin aq gjindarmë sa të dojshin dhe të niseshin për në Tiranë. Me këtë mënyrë Esati e turbulloi opinionin publik t'atij vendi dhe futi farën e urrejtjes kundër qeverisë së Vlonës.Tue e pamë këtë gjendje kaq të trazueme se nuk do të mundesha ta kryej me ndergjegje, detyrën e nënprefektit që m'ishte ngarkue, u ktheva në Elbasan dhe i raportova gjendjen Aqif Pashës të cilit i thashë:-Ju tue kujtue se jeni në rregull e në rrugë të drejtë, vazhdoni të jeni të plogët, Esati e din se ska të drejtë, por punon me energji të çuditshme dhe tue i përdorë të gjithë mjetet e tij djallëzore. Ai po derdh shuma të mëdha në Dibër, kurse ju më thoni se do të çoni ma vonë napolona që të regjistroi nga tridhjet dyzet gjindarmë. Prandaj mue më falni se s'mundë ta kryej detyrën e Nënprefektit të Dibrës. Ndërkohë Ali Bej Zajmi shkon në Dibër. E mbledh parësinë e maleve dhe u thotë që duhet të bashkohen e të kërkojnë një princ me festë kuq. Po atë ditë arrin nga Tirana besniku i Esatit, Man Kruja, dhe mbasi muer pjesë në mbledhje i thotë parësisë që të mos i varin veshin fjalëve të Ali Beut. Ali Beu i turpërue ndahet prej parësisë tue u thanë se kanë me u vertetue fjalët e tija, mbas pak kohe. Ali Beu qe çue në Dibër prej Esatit me këtë detyrë. Përgënjeshtrimi i fjalëve të tij me këtë mënyrë prej të dërguemit të dytë të tij, dha të kuptohet se ai aso kohe s'e gjet të përshtatshme gjendjen politike për të dalë në shesh si kandidat për princ dhe kështu u pendue ose desht të mos i zbulojë krejtësisht gjurmat e veta.sidoqoftë në këtë kohë kësisoj u mbjell në Dibër mendimi për me emrue një princ me fest të kuq d.m.th musliman. Mbas kësaj ngjarje Esati çoj në Dibër nji komision të përbëmë prej këtyne zotnijve: Jusuf Bej Hysen Agolli, Xhelal Bej Mati, Ali Bej Zajmi dhe Sefedin Pustina. Këto qenë ngarkue me detyrë që ta çojshin popullin e Dibrës e të Lumës kundër Ismail Qemalit ose ma mirë me thanë kundër qeverisë së Vlonës dhe për këtë qëllim patën marrë me vete njëmijë e pesëqind lira turke. Xhelal Beu e Sefedin Pustina u rrasën në krahinën e Gollobordës. Këto në Gollobordë nisën me ba një organizim dhe, përdhunisht u përpoqën me e kthye popullin kah Esati. Qe t'ja merrijshin këti qëllimi emnuen krahinor nji kriminel të famshëm të Sebishtës dhe bani oficera shokët e tij gjaksorë. N'anë tjetër Isuf Beu e Ali Beu nën preteksin se do ta lirojshin Dibrën prej serbëve u futën në qytet të Dibrës së madhe në Jugosllavi dhe qysh aso kohe hynë në relacione miqsore me serbët. Gjithashtu as kohe me nxitjen e këtyne u ngrit nji fuqi malsorësh nga Dibra për me sulmue Elbasanin. Kjo fuqi shkoi në Mat por u kthye prapë me qe nuk u pa nevoja. Po n'ato ditë Dervish Bej Elbasani dhe i vëllai i tij Qamil Beu të zemëruem me Aqif Pashën për një tokë që kishte shkaktue nji grindje të vjetër në mes tyne ishin arratisë nga Elbasnai dhe kishin dalë në Çermenikë, ku bridhshin katund më katund tue propogandue në favor t'Esatit e në disfavor të qeverisë së Vlonës. Në këtë mënyrë dy vllezнit me nj'anë dojshin të shpagohen me Aqif Pashën dhe m'anë tjetër t'i shërbejnë Esatit.

Arif Hiqmeti në Dibër dhe veprimet e tij

Pata marrë vesh se nji i quejtuen Arif Hiqmeti dy-tre herë kishte dalë nga Serbia dhe tue kalue përmes Matit kishte shkue në Tiranë e në Durrës. Veç kësaj ishte lajmue se ky njeri, morali i të cilit ishte fare i dobët qenka takue edhe me Ali Bej Zajmin e me Jusuf Bej Hysen Agollin në shtëpi të Ahmet Zogut, në Mat dhe paska lidhë besë me ta. Ish fundi i frorit të vitit 1914. U nisa me shkue në Dibër të vogël. Në këtë rast u ndala në Tiranë dhe u takova me Myftiun e Përgjithdhëm Z. Vehbiun, të cilit ia thashë të gjitha ato që kisha marrë vesht për Arif Hiqmetin dhe se në Dibër, po bëheshin mbledhje kinse për të caktue qendrën e prefekturës. Ku shfaqa edhe dyshimin që kisha me qëllimin e mirë që mund të ndiqesh në këtë punë dhe me anë të tij ia tërhoqa vërejtjen prefektit të Durrësit Z. Mehdi Frashërit. Z. Mehdi Frashëri, në përgjigjen që i çoi Myftiut të përgjithshëm Z. Vehbiut i thoshte se Ahmet Bej Zogu asht thirrur në Durrës se çështja e Arif Hiqmetit s'ka ndonjë rëndësi dhe se për përcaktimin e qendrës së Prefekturës Dibrës do të çohet një komision i posaçëm, i cili ka për të marrë parasysh pozitën gjeografike e politike të vendit në përcaktimin e qendrës.Mbas kësaj përgjigje u nisa dhe shkova në Dibër.Kur sosa në Dibër mora vesh se ArifHiqmeti kishte zanë vend në shtëpinë e Liman Lleshit në Reshen, nji katund nja gjysmë ore lark kufirit të qytetit të Dibrës së madhe dhe prej andej po e helmonte popullin tue ia ngacmue dejt e fanatizmit fetar dhe tue ia argtue prirjet revolucionare, kur i mora vesht këto shkova dhe u takova me Liman Lleshin.Ai më tha se Arif Hiqmeti, ishte një atdhetar i flaktë, besnik dhe i dërguem prej fuqive të mëdha t'Europës në Dibër që të sigurojë sjelljen e një princi musliman në Shqipni.Gjithashtu tha se Ahmet Bej Zogu, ishte kryetar i tyre dhe se rrogat, armët e municionet e gjindarmëve që rregjistrohen çohen prej tij.S'kishte nevojë që të vijshin prej Ahmet Beut të hollat, armët e municionet, mbasi këto.çoheshin nga Serbia.Ma në fund më tha se Arif Hiqmeti premtonte të më bante Senator po të bashkunojsha me të.Meqanëse ato dit Arif Hiqmeti ndodhesh në qytet të Dibrës, nuk u takova me të, por me Limanin ramë dakord që të vijsha me bisedue me Arifin kur të kthente dhe po ta fitojsha të drejtën ky do ta dëbonte nga shtëpija, po të më bindte ai mue të bashkpunojsha me ta dhe në raste se do të ishim në kundësrshtim pikpamjesh do të shkojshim në Durrës bashkë me Arifin dhe do të bajshim arbitër komisionin e kontrollit që aso kohe ndodhesh atje.Kështu u ndamë.Mbas katër a pesë dit shkova dhe u ndesha me Arif Hiqmetin, aty ndodhesh edhe kapiten Xhemali, ish komandant i Gjindarmërisë në Dibër në kohë të rregjimit turk.Ky njeri ishte njoftë me parinë e Dibrës.I vertetonte fjalët e Arif Hiqmetit sa herë që ai të fliste.Ato dit ndodheshin nja tridhjet dyzet malsorë.Të rinjt kishin qëndrue në kambë para tij me duer në zemër dhe pleqtë ishin përkulë në shenjë nderimi.Arif Hiqmeti po u fliste këtyne dhe po u thoshte se Princ Vidi asht austriak.Banon në një katund të Austrisë, asht emnue në Shqipni pa pëlqimin e popullit.Po të dojë e të bashkohet populli Europa ka vendos me çue në Shqipni një Princ, në mos osmanlli, musliman.Unë jam dërgue këtu prej fuqive të mëdha për të bashkpunue me popullin që të kërkojmë të drejtën e zgjedhjes së Princit.

Në këtë çështje kanë gisht shumë njerëz të përmendun të Shqipnisë. Qëllimit do ti arrihet vetëm kur të tregohet eksistenca e jonë këtu.Me fjalë të tilla, Arif Hiqmeti po u gicilonte dejt e zemrës dhe po u a nxente nervat kryengritësve këtyne injorantëve, të cilët kishin mbet si të mahnitun.Princ Vidi asht gjerman u thashë, asht nga qyteti Pedestan dhe zbret prej familjes imperiale.Ne s'mundem me e mbajtë sundimin otoman.Veç kësaj kurrë s'mundemi me e tregue ekzistencën tonë kombëtare.E kaluem kohën me marrëzina.Edhe unë do të dëshirojsha që të jemi nën protektoratën e osmanllinjëve e të kemi një princ musliman.Por e drejta e popullit tonë për të zgjedhë vetë një princ është marrë prej Evropës, mbasi na u pushtuem prej të tjerëve. Megjithë këtë populli shqiptar e ka dhanë pëlqimin e vet për Princ Vidin.Shqipria nuk mund të konsiderohet si një vend që ka fitue indipedencën tue u tregue ekzistencën e vet dhe tue derdhë gjak ashtu si shumë kombe tjerë.Shteti i ri i Shqipnisë asht shqiptar e jo musliman.Prandaj, s'asht mirë që të shkaktohen trazime e turbullime për të sjellë një princ musliman.Mbasandaj shtova se për të ndriçue të vërtetën mund të shkojshin me pyet në Durrës. Unë e dij të vërtetën m'u përgjigj Arifi dhe s'kam nevojë që të shkoj në Durrës.Mbas kësaj përgjigje u thashë atyne që ndodheshin aty: Arifi i ditke të gjitha, prandaj s'paska nevojë me shkue në Durrës, unë mund të mos i dije punët sa ai por ma mirë se ju i di.Kuptohet vetvetiu pra se vetëm ju nuk i dini punët.Tash po të doni besoni Arifin e veproni verbënisht, ose simbas marrëveshjes që kemi pas shkojmë në Durrës për me e marrë vesht të vërtetën dhe mënyrën e veprimit që duhet m'u ndjekë.

-Na i kemi besue Arifit thanë.

Kjo përgjigje më dha të kuptoi se mori fund bisedimi.Megjithë këtë u thashë se veprimi i tyre do të kishte përfundime të kobshme për Atdheun, mund të provokonte një invasion dhe për të gjitha këto kobe e faje të pafalshme ata ishin e do t'ishin përgjegjës. Por ato ishin verbue e shurdhue dhe zemrat e tyne ishin helmue.Në këtë mbledhje ndodhesh present edhe Selman Ballia prej Çermenikës t'Elbasanit.Qenja e tij aty më dha të kuptoj se propaganda e damshme dhe influenca e Arif Hiqmetit i kishte zgjanue kufijtë e vet deri në Çermenikë.Si e tillë, natyrisht, me kohë, do të merrte një ngjyrë politike me randësi.Prandaj menjiherë i shkrova një letër z.Sadik Germenit i emrue nënprefekt në Dibër të vogël, dhe i parashtrova çështjen, gjithashtu shkova dhe vetë në Peshkopi dhe në një mbledhje të këshillit administrative bana një ekspoze të situatës së ndërlikueme dhe ua tërhoqa vërejtjen; por me thanë se çashtja s'ka rëndësi dhe me gjithë atë i paskan shkrue Prefekturës së Durrësit. Megjithkëtë i shkrova dhe Myftiut të Përgjithshëm z.Vehbiut q'aso kohe ndodhesh në Durrës, dhe përsëri ia shpjegova rëndësinë e punës.


NË NUMRAT E ARDHSHËM DO TË LEXONI:

1 - Mbas ardhjes së Princ Vidit në Durrës.
2 - Ç'pamë në Durrës.
3 - Mbasi u kthyem nga Durrsi në Dibër.

© Shënimet e Ismail Strazimirit botohen me lejen e Drita Agollit (Strazimirit) dhe Zeqi Agollit.

Xhamitë po i ndërton populli

Intervistë me Myftiun e Dibrës, kryetarin e Bashkësisë Islame të Shqipërisë dhe kryetarin e Komisionit të Pajtimit të Gjaqeve në Dibër, zotin Ahmet Çaushi



Ka lindur në fshatin Blliçe në vitin 1937. Shkollën fillore e kreu në vendlindje. Mbaroi medresenë në Tiranë shkëlqyeshëm dhe po me nota mjaft të mira mbaron dhe shkollën pedagogjike në Peshkopi. Fill pas mbarimit të shkollës fillon punë si mësues në Fushë Alie. Pak kohë më vonë do të bëhet drejtor i parë i shkollës në Shumbat, e cila sapo ishte hapur. Drejtor shkolle në Kastriot. Mësues në Qafë Murrë dhe Grevë. Pasioni i tij është historia dhe folklori aq i pasur i Dibrës, për të cilët ka mbajtur dhe shënime.

Kur filluat punë si Myfti i Dibrës dhe mbi ç'baza e nisët këtë detyrë?

Si Myfti i Dibrës u caktova në vitin 1997, vit ky që jo vetëm në Dibër, por në të gjithë vendin la një shije të hidhur. Në fakt nuk ishte vetëm Dibra që mbuloja unë. Këtu futej dhe Bulqiza dhe Mati, e situata ishte tepër e acaruar. Ne si myftini, në fakt, na mungonte kuadri i nevojshëm, pasi mungesa e arsimimit vlente për të dëshiruar. Imami sot është si për bujkun dhe blegtorin ashtu dhe për arsimtarin dhe inxhinierin, për politikanin dhe shkencarin. Megjithatë arsimimi i njerëzve tanë ka çaluar herët dhe jo sot. Megjithatë, bashkë me stafin tim filluam nga puna për të kultivuar tek besimtarët tanë kulturën islame. Islami synon gjatë gjithë aktivitetit të tij ta çojë njeriun drejt përsosjes. Puna e myftinisë dhe e kuadrit të fesë islame fillon me të gjitha etapat njerzore, nga lindja deri në vdekje. Pra, me bindje, them se e nisëm punën në kushte mjaft të vështira dhe sot jemi të bindur se kemi bërë diçka të mirë dhe të bukur për Dibrën dhe dibranët. Megjithatë themi se do të bëjmë edhe më shumë. Kjo i takon një të ardhmje të afërt. Le të presim.

A ekziston ndonjë shkollë fetare në Peshkopi dhe nëqoftëse është si frekuentohet kjo nga të rinjt dhe të rejat?

Në fillim, ashtu si në shumë rrethe të vendit, edhe në qytetin e Peshkopisë u hap një shkollë fetare. Qysh në fillim kjo filloi të frekuentohej nga të rinj e të reja. Stafi ishte i kompletuar, por edhe rezultatet e nxënësve ishin në nivel të lartë. Kjo ishte si një ëndërr e bukur, pasi në vitin 1995 kjo shkollë u mbyll. U detyruam atëherë që nxënësit e Dibrës t'i dërgojmë drejt Tiranës. Megjithse përsëri ka mjaft të rinj dhe të reja që vazhdojnë medresenë në Tiranë, përsëri kërkesat janë për më shumë, por kjo është e pamundur pasi numri është i kufizuar. Megjithatë, ne punojmë vazhdimisht me brezin e ri, por kjo nuk mund t'i plotësojë mungesat e shkollës. Ndaj do të kërkojmë vazhdimisht për domosdoshmërinë e një shkolle fetare në qytetin tonë. Vlen të përmend që falë besimtarëve tanë ato janë të gjithë intelektualë. Nga kjo ka ardhur ajo që nuk është krijuar asnjëherë boshllëk për literaturë fetare. Sot pothuaj në çdo shtëpi dibrane gjen literaturë fetare.

Nga viti 1997 e sot çfarë është investuar në myftininë e Dibrës, sidomos në objektet e kultit?

Shteti nuk investon fare, të paktën në Dibër. Disa herë na është premtuar, por tashmë ato kanë mbetur vetëm premtime. Dibranët nuk kanë mjaftuar me premtimet e shtetit. Kështu që janë ndërtuar mjaft xhami nga donator dhe populli.

Xhamia në Kllobçisht u ndërtua nga shqiptaro-amerikani Sulejman Bekteshi. Në Brezhdan nga Avni Gazidede. Në Çetush nga Rruzhdi Bulku. Në minaren në Limjan nga Musa Rriçku. Në fshatrat Pejkë, Vranjt, Borovjan, Blliçe, Çidhën, Herbel, Rrashnapojë, Sinjë dhe e 77-ta në Shumbat po ndërtohen me kontibutin e vetë banorëve. Pra, edhe pse shteti ka heshtur në këtë drejtim, vetë njerëzit kanë investuar shumë. Ky kontribut i njerzve po rritet dita ditës dhe në të ardhmen, them me bindje, do të kemi më shumë investime.

Çfarë roli luajti myftinia në ngjarjet e marsit 1997?

Kur pamë se populli u armatos dhe katastrofa ishte fare pranë, na takonte ne që të ulnim gjakrat. Për këtë u mblodhën në myftini dhe dolëm disa herë ne mediat lokale duke i bërë thirrje popullit për qetësi dhe gjakftohtësi.Morëm pjesë direkt vetë në konflikte të mëdha mes fshatrave siç ndodhi mes Dovolanit dhe Herbelit. Them sot me bindje se puna jonë pati rezultat, ajo dihet tashmë nga vetë fakti për gjakftohtësinë që mbajtën dibranët në këtë situatë tepër të acaruar.

Jeni dhe kryetar i Komisionit të Pajtimit të Gjaqeve në Dibër. Çfarë roli ka luajtur ky komision në konflikte të mëdha por dhe të vogla qofshin ato? Sa gjaqe janë pajtuar deri tani?

Nga koha që ka filluar të funksionojë ky komision e deri më sot, kemi pajtuar 15 gjaqe si në Shumbat, Rrenx, Grykë Nokë etj. Kjo nuk është një shifër e vogël. Megjithatë, ne nuk mjaftohemi me kaq. Përsëri misionin tonë e vazhdojmë dhe jemi në bisedime për të pajtuar dhe mbyllur shumë konflikte që mund të acarohen dhe të degjenerojnë në plagë të gjakmarrjes. Për këtë mund të përmend për kontribut dhe punë të mirë që kanë bërë në këtë drejtim Hafiz Pajazit Tafa, Mehmet Shehu, Nazmi Shehu, Hajri Shehu, Qazim Shehu, Rruzhdi Hoxha, Burhan Shehu, Hivzi Shehu, si dhe mjaft persona të tjerë nga të afërmit e të konfrontuarve.

Dibranët shquhen për mikpritje dhe kjo ua rriti më shumë vlerat në pritjen që u bënë kosovarëve në vitin 1999.Myftinia ka luajtur ndonjë rol në këtë mes dhe si?

Sapo karvanet me kosovarë kaluan nga Morina pushteti vendor u mblodh për të patur situatën nën kontroll dhe për të siguruar mikpritjen e kosovarëve. Në atë mbledhje kam marrë pjesë edhe unë. Nuk ishim në gjendje se sa kosovarë mund të ia behnin në Dibër dhe nuk dinim si do të vepronim. Në prefekturë kam bërë unë i pari thirrjen: -Kush ka tre dhoma një ta lirojë për kosovarët. Kaq u desh dhe nga qyteti erdhën 200 strehuesit e parë që liruan dhomat dhe pa qera. Fakt është se në shtëpitë e qytetarëve kosovarët hanin bukë bashkarisht dhe të pandarë.Jo vetëm kaq, por në konviktin e shkollës bujqësore ku ishin strehuar pak kosovarë, një burrë nga Staraveci u çonte qumësht kosovarëve tek konvikti. Kosovarët kërkuan me këmbëngulje që ta njihnin këtë njeri të mirë që ju falte çdo mëngjez qumështin e lopës së vetme por nuk mundën kurrë.Ai mbeti, si dje ashtu dhe sot, njeri anonym, por njeri me zemër të madhe që ju shërbeu kosovarëve në momentet më të vështira që kaluan. Ka edhe raste të tjera por mjaftojnë kaq që të vërtetohet plotsisht mikpritja dhe bujaria dibrane.

Mendimi juaj për gazetën "rruga e Arbrit"?

Sapo u informova se doli numri i parë i kësaj gazete shkova dhe e mora. I kam lexuar të gjithë numrat që kanë dalë. Mua më takon t'ju përgëzoi për këtë nismë të bukur dhe humane që keni marrë. Jam i bindur se kjo gazetë do të ketë të ardhme.Them se do të ketë të ardhme se është organ i shoqatës së intelektualëve dibranë, drejtohet nga një staf i kualifikuar, ka trajtuar probleme që shqetsojnë Dibrën dhe dibranët. Dibra meriton një lapidar që ta shikojë edhe Shkupi edhe Prishtina, edhe Durrësi edhe Shkodra. Dhe bindem se kjo gazetë do ti pasqyrojë ato vlera të bukura që mbart Dibra. Duke përfunduar ju uroj Urime dhe suksese në këtë mision që keni nisur.

Bisedoi:
MUSA RRIÇKU

Njeriu që flet pak dhe punon shumë

(Vijon nga faqja 3)



Ndërtimet e së ardhmes

Sot shoqëria "Almo Konstruksion" disponon makineri të ndryshme si për ndërtim dhe asfaltim rrrugësh, ndërtim urash të mëdha dhe apartamentesh banimi. Kapaciteti teknik i kësaj shoqërie përbën një kantier më vete. Makineritë që disponon janë: Kamiona vetshkarkues 26 tonësh, 10 tonësh, 7 tonësh, borëpastruese me impiant kripe, rula vibrues, greder, asfaltoshtruese, rimorkiator, eskavator, fadromë me goma, gjenerator të mëdhenj 37 KVA, vibrator thellsie, prerëse asfalti, lopatë borë pastruese, kombinat zdruktarie, betoniera, ngjeshës mekanik, pompë trokreti, matrapik elektrik, pompë uji e fuqishme, pistoletë ajri, etj. E gjithë kjo makineri e ndryshme si dhe personeli i kualifikuar, si kuadro dhe ai i specialistëve, të jep të kuptosh se shoqëria "Almo Konstruksion" ka kapacitet dhe profesionalizëm për të investuar dhe në vepra të mëdha.

Por, Shaban Bitri, nuk është lidhur me vendlindjen ndërmjet investimeve, se ato ende janë pak, fare pak. Në të ardhmen, ndoshta, do të bëjë më shumë për Dibrën dhe aftësitë profesionale i ka. " Dibra ka nevojë për investime kudo, - thotë Shabani. Edhe folklori aq i pasur, studimi, historia, artet dhe kultura, investime janë. Ndaj qysh këtu duhet ndërhyrë. Të tjerë nuk kanë vlera dhe mundohen të ngrejnë ato. Ne i kemi dhe të mos i humbasim, por t'ua përcjellim brezave".

Shabani është i dhënë shumë pas këtyre vlerave që mbart Dibra. Ai është i dhënë shumë pas folklorit aq të pasur, pas historisë dhe kulturës. Çdo gjë e mirë dhe e bukur që flet për Dibrën dhe dibranët për Shabanin ka vlerë dhe faktet flasin vetë. Shaban Bitri ka sponsorizuar disa herë aktivitete kulturore si promovime librash, simpoziume shkencore e historike etj.

MESAZHE DHE URIME

Te nderuar botues dhe anetare te redaksise se Gazetes "Rruga e Arberit "!

Ju përshëndes për iniciativen që keni marrë për botimin e gazetës me drejtim njohjen e Dibrës, por duhet të bëhet kujdes pasi është një përgjegjësi shumë e madhe për të botuar për Dibrën, Dibranët dhe intelektualet e saj. Kjo pasi njerëzit e Dibrës janë të shumë kalibreve dhe nëse do të flitet për ta kërkohet penë e fortë. Sipas këtij këndvështrimi, nëse do të mjaftoheshit me përshkrime të thjeshta nostalgjike, do të gaboni dhe nuk do të arrini qëllimin për të cilin jeni kujdesur për të arritur nëpërmjet shoqatës së krijuar. Kujdes duhet të bëni në mbivlerësimin e Dibrës dhe të dibranëve ne raport me trevat e tjera të Shqipërisë apo në ndarjet e dibranëve në kategori të ndryshme, etj. Gjithsesi kjo iniciativë që ju keni marrë është për t'u përshendetur. Duke ju falenderuar për mirëkuptimin ju uroj rrugë të mbarë dhe me shkrime cilësore .

Me shumë respekt: Av.Kadri Skera

* * *

Uroi nga zemra gazetën "Rruga e Arbërit". Suksese në punën tuaj. Si dibranë që jam kam një kërkesë: shkruani më shumë për këngët dhe vallet e bukura qytetare dibrane, dhe po është e arsyeshme le të jepet një koncert në qendër të Tiranës. Ndryshe ato po shuhen dalngadalë. Ju me punën tuaj fisnike pastrojeni këtë pluhur që u ka rënë. *tel:0682957560*

* * *

Urime gazetës dhe stafit tuaj. Udha është e gjatë dhe me pengesa. Them se do të dini ti kaloni këto pengesa. *Adriatik Beluli. Tel:068207399*


* * *

Gazetës "Rruga e Arbrit" i uroi jetë të gjatë. Sukse dhe vetëm suksese. *Shefki Laçi, 0682944764*

Jashari i paharruar

Prof. Dr. SHABAN SINANI

Në rrethin e miqve dhe të njohurve të Jashar Menzelxhiut, të cilët ishin të shumtë dhe nga gjithë Shqipëria, kam hyrë vonë, në dy dekadat e fundit të shekullit të kaluar. Qysh gjatë fëmijërisë, emrin e tij e kisha dëgjuar të përmendej me nderim dhe madje me mburrje prej bashkëvendasve të mi (dibranë), të cilët e ndiqnin me vëmëndje dhe simpati të hapur kudo që e çonte detyra: Nga Peshkopia në Elbasan, mandej në Sarandë dhe në fund në Tiranë. Ato kohë, Jashar Menzelxhiu, për ato që e përmendnin në kuvendimet e përditshme, ishte "Njeriu i Qeverisë". Nuk më ka rastisur ndonjëherë të kem dëgjuar të flitej për atë si udhëheqës partie. Në figurën e Jasharit herët a vonë, të moshuar a të rinj, shihnin "shqiptarin e vjetër"atdhetar, që gjithashtu ndihej shumë mirë e aspak skematik, edhe në simetri me "njeriun e ri" Jashar Menzelxhiu u ushqye dhe u rrit bashkë me idetë komuniste në Shqipëri, ide, që për një kohë të gjatë, përbënin pararojën e mendimit njerëzor, jo vetëm në Lindje, siç kuptohet shpesh, por edhe në Perëndim. Ai u bë pjesë e kësaj lëvizje (doktrine) duke qenë, gati-gati një Debatikas, që u bë shpejt protoganist, si njeriu që mundësoi, p. sh, rrëmbimin e Arkivit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ku gjendeshin projektet e goditjes së kundërshtarëve të Qeverisë bashkëpunuese të fashizmit. Gjatë viteve që pata nderin të hyj në rrethin e miqve dhe të njohurve të Jashar Menzelxhiut, m'u konfirmua gjithçka që kisha dëgjuar për të. Pra, ai kishte të gjitha cilësitë për të qenë lider.



Së pari: komunikimin e përkryer, një vlerë jo aq e zakonshme për udhëheqësit, sidomos ata të administratës vendore, të cilët shpesh i jepnin vetes një plotfuqishmëri të habitshme.

Së dyti: lirshmërinë, cilësi kjo edhe më e rrallë, madje mund të thuhet mahnitëse. Ai kishte zotësinë që gjërat e logjikshme ti bënte gjëra të partishme. Dhe kështu kurdoherë gjendej në pozitë të shëndetshme.

Së treti: Jashari ishte një shembull i jashtzakonshëm i njeriut që, duke mos pasur asnjë prirje disidence apo opozicioni, njëkohësisht kishte liri brenda vetes dhe dinte që "vijën" ta bënte, si të thuash, autostradë, dhe askush të mos gjente shkas për ta qortuar. Përkundrazi, mund ta gjeje duke kënduar me çamët apo me minoritarët në Vurg të Sarandës. Në mesin e viteve 1960, kur erdhi radha e kolektivizimit të bujqësisë në zonat malore, dibranët e thellsive, që nuk ishin të bindur se duhej të bashkonin tokën, thoshin: Vetëm Jashar Menzelxhiu të mos na çojë partia, se ai ka për ta na e prishur mendjen. Kjo sepse Jashari nuk zgjatej shumë me strategjinë e komunizmit, por i thjeshtonte gjërat dhe kështu i bënte bindëse.

Së katërti: Jashar Menzelxhiu ishte njeri i vetveprimit. Kur një lëvizje ndërmerrej si nismë prej tij, ndryshonte prej lëvizjeve skematike revolucionare për ti bërë qejfin Udhëheqjes.

Së pesti: Jashar Menzelxhiu karakterizohej nga përgjegjësia. Me atë nuk ka ndodhur kurrë që në çaste rreziku të gjente një vartës apo një zyrë për të shkarkuar gabimin. Për këto arsye, ne duhet t'i jemi mirënjohës Prof. As. Dr. Vangjel Kasapit, autor i këtij studimi dhe botimi, që me shumë dashamirësi, realitet dhe kompetencë shkencore, e solli Jashar Menzelxhiun para lexuesit shqiptar.

FTESË

Gazeta "Rruga e Arbërit" është e hapur për çdo lloj bashkëpunimi. Të Interesuarit mund të sjellin opinionet e tyre për çeshtje e probleme të ndryshme që shqetësojnë Dibrën e dibranët. Redaksia mbetet e hapur për çdo lloj bashkëpunimi, me synimin e vetëm: përhapjen e së vërtetës dhe mendimit progresist.

Redaksia kujton bashkëpunëtorët se dorëshkrimet janë të pakthyeshme dhe jo çdo shkrim mund të botohet.

Tel.068 31 19 232. Tel: (04) 357 179.
Email: lid_gazeta@yahoo.com

KONKURS

Në kuadër të botimit të kalendarit "Dibra 2007", ftojmë të interesuarit, fotografë dhe amatorë, të sjellin fotografitë e tyre për kalendarin. Fotografitë do të përzgjidhen nga stafi i botimit të kalendarit. Fotot që do të botohen do të shpërblehen. Fotot duhet të jenë të shoqëruara me një shënim shpjegues, por jo më të gjatë se 30 karaktere.
Fotografitë duhet të jenë dixhitale ose të stampuara në format kartoline të shoqëruara me negativin.

Për më shumë informacion telefononi në numrin: (04) 233 283 ose shkruani në email: mbujar@yahoo.com

Shaban Xhajku - interpretuesi më i mirë i Valles, Lushnje, 2006

Emri i Shaban Xhajkut është bërë i njohur ndër vite, që në fshatin e tij të lindjes, në Trene të Dibrës. Emri i tij si artist u kristalizua në gjithë Festivalet Kombëtare të zhvilluara në Gjirokastër dhe Berat që nga viti 1978. Vallja dibrane, veças ajo dyshe, me interpretimin e Shaban Xhajkut mori jetë dhe u bë e njohur në të gjithë vendin dhe jo vetëm këtu. Me Ansamblin "Dibra" ka interpretuar vallen dibrane në skenat e Austrisë, Turqisë, Kosovës, Maqedonisë etj. Pikërisht vallja, intepretimi i saj, e bënë atë "Interpretuesin më të mirë të Valles Popullore", kurorëzim ky i dhënë në Festivalin Folklorik Tipologjik Kombëtar, në Lushnje, 28 Maj 2006.



Pas pesë vëllimeve me poezi, Naim Berisha prezantohet denjësisht edhe në prozë

"Vetëvrasja e shpirtit" në romanin e Naim Berishës



LIBRA TË AUTORIT:

"Ngado sytë e vajzës", *poezi, 1993*
"Lejlekët e lumit tim", *poezi, 1995*
"Hiq dorë", *poezi, 1996*
"Zog i qiellit", *poezi, 2002*

Duke u përpjekur të përshkruajë në detaje gjithshka ndodh në qytetetin verilindor në zemër të maleve, Naim Berisha krijon epopenë gjeografike të vendlidhjes së tij, Dibrës, e cila deri në këto kohë mungonte në letërsinë artistike. Këtu ai hedh dritë për origjinën e kastriotëve duke përshkruar bëmat e pjesë të historisë së tyre të lavdishme.

Në harkun kohor të 13 viteve, Naim Berisha ka hyrë me dinjitet në historinë e letrave shqipe, jo vetëm si poet, por edhe si prozator. Kështu pas pesë vëllimeve me poezi, të mirëpritur nga lexuesi dhe nga kritika letrare ai paraqitet me romanin e tij të parë "Vetëvrasja e shpirtit". Ky roman ka një galeri të tërë personazhesh, por pa dyshim vend qëndror në të zënë figura e artistit Andi Egro dhe Renza Kulojsna, një inferemiere perfekte. Veprimi i dy personazheve kryesorë ndeshet pothuajse në 25 pjesët e romanit. Shkaktari i fundit tragjik të Renzës, që i shfaqet për ditë, javë, muaj e vite të tëra si fantazëm, pothujase nuk gjen qetësi shpirtërore, në asnjërën nga lidhjet e tija të mëvonshme.

Romani ka një ndërtim interesant e disi të veçantë, duke ndërthurur dy linja që ecin paralel me njëra tjetrën: atë të traditës dhe atë të dashurisë njerëzore.

Linja e parë, pra ajo e traditës ka të bëjë me vendgjarje si qytetet e Mazrekës e Uskanias e Vajlotin, një rrethinë e tyre, por dhe me personazhe të kohëve të herëshme si plakun e moçëm Stopan Zeheri, Gjorg Kulojsën apo dhe Dan Përlekën që shfaqen si kreshnikët e maleve në momente mortje, me karaktere të fortë dhe burrërorë. Në ditë të tilla mortje ata ngushëllojnë njëri-tjetrin dhe po bashkë përballojnë të gjitha të papriturat e rreziqet.

Linja e dytë e romanit na shpalos me tablo të gjalla jetën e fatin e infermieres së Lixhave të Ujmishtës, e cila u vetflijua në kulmin e moshës rinore. Ndërkohë në këtë linjë lëvrijnë personazhet të tillë si Andi Egro e bashkëshortja e tij, Ana që kurrësesi nuk arrin ta zëvendësojë Renzën në mëndjen e zemrën e Andit.


Nga faqja në faqe, nga kapitulli në kapitull, nga ngjarja në ngjarje ata zbulohen më të plotë e më bindës...

Duke u përpjekur të përshkruajë në detaje gjithshka ndodh në qytetetin verilindor në zemër të maleve, Naim Berisha krijon epopenë gjeografike të vendlidhjes së tij, Dibrës, e cila deri në këto kohë mungonte në letërsinë artistike. Këtu ai hedh dritë për origjinën e kastriotëve duke përshkruar bëmat e pjesë të historisë së tyre të lavdishme.


Duke lexuar këtë roman ndodhesh në një botë krejt të veçantë, me ligjet dhe kushtet që shoqëruan këto vite të tranzicionit edhe në qytete provincialë siç aludon autori për Peshkopinë. Bashkë me zhvillimin e ngjarjeve e karaktereve, me krijimin e situatave të reja, dalin në pah edhe perceptimet e autorit për mënyrën e të dashuruarit, duke patur si pikë referemi autorë të njohur të kohërëve moderne.

Halil RAMA

BOTIME TË AUTORËVE DIBRANË







*Grafika: **Studio "m&b"**. Tel: (04) **233 283**. Shtypur në shtypshkronjën "**Dita 2000**". Tel: (04) **273 745***